



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 10.04.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 07.04.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "CONDES" për aktivitetin: "Ndertimi I Qendres Kulturore për të rinje-Bibliotekes në lagjen Kodra e Trimave" dhe me numer të prokurimit 616 19 9417 511 nxjerr:

V E N D I M -KORIGJIM VENDIMI

1.Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "CONDES" "e datës 07.04.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit" Ndertimi I Qendres Kulturore për të rinje-Bibliotekes në lagjen Kodra e Trimave" dhe me numer të prokurimit 616 19 9417 511 kundër njoftimit të vendimit të AK –së, të datës 02.04.2020 të publikuara në web-faqe të KRPP-së.

2.Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin sipas publikimit të datës 02.04.2020.

3.Ky vendim i korigjuar hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "Condesi" me datë 07.04.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: " **Ndertimi I Qendres Kulturore për të rinje-Bibliotekes në lagjen Kodra e Trimave**" dhe me numer të prokurimit 616 19 9417 511

Autoriteti Kontraktues, me datë 08.04.20120 ka rishqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Autoriteti Kontraktues gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës gabimisht e ka trajtuar një referencë si të pranueshme edhe pse nuk është e tillë. Fjala është për referencën lidhur me Ndertimin e shkollës në fshatin Leshan të Pejës, e cila ka datën e pranimit 23.12.2019 dhe që është realisht me e vonë në krahasim me datën e publikimit të Njoftimit për kontratë (09.12.2019). Bazuar në dispozitat ligjore dhe kërkesat e FDT-se rrjedh se kjo referencë nuk është e pranueshme dhe rezultoni se komisioni ka vepruar drejt kur e ka trajtuar si të tillë dhe se trajtimi i gabuar është bërë gjatë shqyrtimit të kërkesës tuaj. Lidhur me këtë ua perkujtoj kërkesën nga FDT-ja si vijon:

Operatori ekonomik duhet te ofroj deshmi se ka perfunduar kontrata per ndertim te objekteve te ndertimit te larte ne tri vitet e fundit(**duke filluar nga data e publikimit te njoftimit per kontrate**)ne vlere minimale prej 800,000.00 euro.

Per korektesi ndaj jush ju sqarojme se nga listat dhe deshmite e ofruara per dy anetaret e grupit: "Euroconstruction" dhe "Jetmiri" jane trajtuar te prqnueshme referencat ne vijim:

Per "Euroconstruction:

1.Ndertimi i aneksit te kuzhines ne FSK ne vlere prej 159,817.65 euro dhe aneks kontrata per te njejten ne vlere prej 14,219.65 euro;

2.Ndertimi i objektit te QKRS-QKRA ne Istog ne vlere prej 309,155.18 euro dhe aneksi ne vlere prej 6,369.46 euro.

Per "Jetmiri:

1.Rregullimi i rrethojes ne Kampusin Universitar ne Mitrovice ne vlere prej 26,367.60 euro;

2.Ndertimi(renovimi)inlapidarit te familjes Rama ne vlere prej 19,531.25 euro;

3.Ndertimi i murit mbrojtës ne Breshanse dhe dhe Stravaqine ne vlere prej 16,019.00 euro;

4.Ndertimi i lapidareve perkujtimor dhe mirembajtja ne vlere prej 49,941.03 euro.

Keto kane qene te gjitha deshmite qe kane mund te trajtohen si deshmi per realizim te punimeve te ndertimit te larte dhe totali i tyre eshte 601,421.06 euro(489,562.18 nga "Euroconstruction" dhe 111,858.88 per "Jetmiri"

-Lidhur me pretendimet se duhet te jene te praueshme edhe punet e renovimeve ju sqaroj se kerkesa e FDT-se e paraqitur edhe ne kete Vendim ka qene e qarte se duhet te ofrohen deshmi per ndertim te objekteve te ndertimit te larte dhe lidhur me kete ju keni pase te drejt ligjore ta kontestoni kerkesen ne kohen sa ka qene tenderi i hapur,para dorezimit te tendereve.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Kerkoj nga Zyrtari i prokurimit qe administron kete aktivitet qe ta publikoj ne E prokurim si Vendim i korigjuar sipas kerkeses per rishyrtim dhe ta percjell edhe te administratorja e faqes zyrtare te Komunes per publikim.

Per shkak te pandemise deklaroj se ky dokument i panenshkuar ka te njejten barasvlere si dokument i nenshkuar.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës ,

-Departamentit të prokurimit; dhe

-Njësisë së kërkesës.

Zekë Bardhaj
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

